



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**ZL Anr. 667/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Rrezarta Avdyli Nuha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. Pranohet** si i bazuar apeli i Rrezarta Avdyli Nuha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për vendvotimin 2216E/01D.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutin së votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Rrezarta Avdyli Nuha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, në të cilën pretendon se në vendvotimin 2216E/01D, ka më shumë se 18 vota dhe kwtto pretendime i vwrtoojnw dwshmitarwt emrat e tw cilwve i ka cekur nw apel.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

## **Apeli është i bazuar**

Paneli, me datë 11.11.2017, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në Kutinë e Votimit 2216E/01D, është konstatuar se ka pasur parregullsi, andaj PZAP ka urdhëruar Komisionin Qendrorë të Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për vendvotimin 2216E/01D.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 667/2017 më datën 12.11.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
Gyltene Sylajman



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.